



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. ____ prot

Tiranë më ____ . ____ . 2024

**VENDIM
Nr. 397, datë 30.07.2024**

MBI

**RISHPËRNDARJEN (TRANSFERIMIN) E FONDEVE BUXHETORE NË
PROGRAMIN 03310, NË SHPENZIME KAPITALE, PËR VITIN BUXHETOR
2024**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, ligjit nr. 97/2023 “Për buxhetin e vitin 2024”, Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, Udhëzimit Plotësues nr. 1, datë 24.01.2024 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2024”, të Ministrisë të Financave dhe me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rishpërndarjes (transferimit) të fondeve buxhetore, në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime kapitale (investime), për Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, për vitin buxhetor 2024, sipas pasqyrës bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.
2. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

P a s q y r a
e rishpërndarjes (transferimit) të fondeve buxhetore, programi 03310, në shpenzime kapitale (investime), viti 2024

në lekë

Enti i Qeverisjes	Ministria e Linjës	Kod Instit.	Emër institucioni	Kapitulli	Programi	Llogaria ekonomike	Kodi i degës së Thesarit	Kod Produkti	Emërtimi i produktit	Debiti
Pakësohet										
001	29	1029001	KLGI	01	03310	2310000	3535	M290068	Rikonst. i pjesshëm	10,200,000
Totali										10,200,000
Shtohet										
001	29	1029042	Gj.e Shk. Parë KKO	01	03310	2310000	3535	M290068	Rikonst. i pjesshëm	10,200,000
Totali										10,200,000